

Objekti i aktivitetit te shoqërisë: Shoqëria "Albgaz" sh.a. është shoqëri me kapital 100 % shtetëror, që vepron si operator i kombinuar i gazit natyror duke kryer veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

1. Albgaz është certifikuar nga ERE si operator I kombinuar I gazit natyror, konkretisht:

- ERE me **Vendim nr. 179, datë 08.11.2017** "Mbi certifikimin e Shoqërisë "Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror" Albgaz sh.a", ka vendosur: *"Miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC.*
- ERE me **Vendim nr. 63 datë 23.04.2019** Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, "Mbi certifikimin e Shoqërisë "Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror" Albgaz sh.a." të ndryshuar ka vendosur: *(i) Albgaz sh.a. të përfundojë brenda tre muajve procedurat e aplikimit pranë institucioneve përgjegjëse për pajisjen me certifikata pronësie për të gjitha asetete që disponon. (ii) Shoqëria Albgaz sh.a. të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 31 Maj 2019, Programin e Përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 77, datë 26.05.2017 e Bordit të ERE-s. (iii) "Albgaz sh.a të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor."*
- Në fund, me **Vendim Nr. 221, Datë 20.12.2019** "Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, ka vendosur: *Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE nr. Nr. 63, datë 23.04.2019, deri në datë 20.06.2020; Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 4 vendimit të bordit të ERE nr. Nr. 63, datë 23.04.2019, deri në 20.12.2020.*

2. Për transmetimin e gazit natyror, shoqëria është e licensuar nga ERE. Konkretisht:

- Me **Vendim të ERE nr. 188, datë 10.11.2017** "Mbi licensimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror" , ka vendosur: *të licencojë shoqërinë "Albgaz" sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror për një afat 30 – vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6 muajor në mbështetje të nenit 24 pika 2 të Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar".*
- Me **Vendim te ERE nr. 262, date 19.12.2018** për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, ka vendosur të shtyjë afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më date 04.03.2019.

- Me **Vendim të ERE nr. 37, Datë 04.03.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, i ndryshuar ka vendosur të shtyjë depozitimin e dokumentacionit të munguar brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, që ka të bëjë me Dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar; Lejet dhe autorizimet mjedisore; një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD..”
- Së fundmi, me **Vendim Nr. 220, Datë 20.12.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albغاز sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar që brenda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

Konstatohet se akoma, mbetet I paplotësuar (i) kushti I pajisjes me leje mjedisore; si dhe (ii) sigurimi nga një shoqëri sigurimesh.

Aktiviteti I transmetimit kryhet vetëm nëpërmjet një linje dhe vetëm për një klient Albpetrol sh.a.

3. Për shpërndarjen e Gazit Natyror shoqëria është licensuar nga ERE, Konkretisht:

- Me **Vendim te ERE nr.187, datë 10.11.2017** “Mbi Liçensimin e shoqërisë Albغاز sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30 – vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6 mujor në mbështetje të nenit 24 pika 2 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar”.
- **Me vendim te ERE nr. 261, date 19.12.2018** për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, ka vendosur të shtyjë afatin e plotësimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 04.03.2019.
- Gjithashtu, me **Vendim të ERE nr. 36, Datë 04.03.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, i ndryshuar ka vendosur të shtyjë afatin e plotësimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 20.12.2019. Dokumentacioni I munguar ka të bëjë me: Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën

licencën e kërkuar; Lejet dhe autorizimet mjedisore; një çertifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD..”

- Së fundmi, me **Vendim Nr. 220, Datë 20.12.2019** “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar *ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 20.06.2020.*